



PËRDITËSIM

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, Mbrojtja paraqiti mendimet e saj se si duhet të zhvillohen procedurat në lidhje me zhdëmtimin e viktimave. Mbrojtësi i z. Shala argumentoi se çështja e zhdëmtimeve eventuale duhet të shqyrtohet vetëm pasi të ketë përfunduar gjykimi, në dallim nga mbrojtësi i viktimave, i cili ka kërkuar që seancat gjyqësore për zhdëmtimin të zhvillohen paralelisht me procesin penal. Mbrojtësit e z. Shala u pajtuan me mbrojtësin e viktimave se në rast të dhënies së një vendimi fajësie, Trupi Gjykses duhet të urdhërojë drejtpërdrejt zhdëmtimin, e jo ta dërgojë këtë çështje për padi civile në Kosovë.

Trupi Gjykses nuk ka marrë ende një vendim për këtë çështje.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, më 15 nëntor, nxori një vendim për afatet e dorëzimit të parashtrimeve nga palët në lidhje me kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për dëgjimin e dëshmitarëve të tetë dëshmitarëve para gjykimit, për shkak të moshës dhe gjendjes së tyre shëndetësore.

Më 11 nëntor, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi një shtesë të mocionit të saj të paraqitur më parë në lidhje me këtë çështje. Në bazë të Rregullores, Prokuroria duhet të dorëzojë përgjigje ndaj kësaj shtese, nëse ka, brenda dhjetë ditësh.

Sidoqoftë, në vendim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ushtroi diskrecionin e tij për shkurtimin e afateve të përcaktuara në Rregullore, duke urdhëruar Prokurorinë që të dorëzonte përgjigjen e saj ndaj shtesës deri të premtën, 18 nëntor 2022. Ai gjithashtu urdhëroi Mbrojtjen që të dorëzonte përgjigjen e saj ndaj çdo mocioni të Prokurorisë deri të mërkurën, 23 nëntor 2022.

Arsyetimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake për shkurtimin e këtyre afateve lidhet me synimin e tij për t'ia dorëzuar dosjen e çështjes gjyqësore trupit gjykses deri në fund të këtij viti dhe, rrjedhimisht, me nevojën për të përparuar sa më shpejt me këto aspekte.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, në vendimin e tij të fundit të 11 nëntorit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, lejoi ndryshimin e afateve për rishikimet e ardhshme të paraburgimit të z. Thaçi dhe z. Veseli, kërkuar nga dy ekipet e Mbrojtjes gjatë konferencës së fundit për ecurinë e çështjes. Rrjedhimisht, vendimet vijuese për rishikimin e paraburgimit të z. Thaçi dhe z. Veseli do të nxirren jo më vonë se të hënën, 19 dhjetor.





Në lajme të tjera, Gjykatësi i Vetëm ka miratuar kërkesën e z. Lajçi për apelimin e vendimit të fundit në lidhje me kërkesën e tij të dytë për pushimin e hetimit të ZPS-së kundër tij. Ky vendim gjendet në faqen e internetit të DHSK-së.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

